



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
QENDRA KULTURORE TIRANA

Nr. 447-Prof

Tiranë më 18.10.2018

### Letër Falenderimi

**Drejtuar:** Prof. Dr. Erenestina Halili, drejtuese e Klubit të Dramës - Fakulteti i Historisë dhe të Filologjisë, Tiranë

Kjo letër falënderimi është për bashkëpunimin e frytshëm me kolazhin "Migjeni" një montazh me pjesë nga krijimtaria e autorit, si veprimtari pjesëmarrëse në Edicionin e Dytë të Festivalit MetroFest- Drama Shqipe si laborator njohjeje dhe kërkimi.

Puna e Teatrit Metropol është duke u shtrirë dhe fuqizuar çdo ditë e më shumë në drejtim të një realiteti të qëndrueshëm në nxitjen e programeve inovative që mundësojnë shtrirje dhe komunikim më të thjeshtë me publikun e të gjitha shijeve sidomos mes dramaturgisë dhe krijimtarisë shqiptare dhe dëshirojmë të theksojmë se kjo mundësi ka qenë shumë e dobishme për ne dhe shprehim mirënjohjen për besimin dhe bashkëpunimin tuaj për ta realizuar me sukses.

Në këto vite të ndryshimeve dinamike, shoqëria shqiptare e ka shumë të nevojshme mbështetjen e programeve që ofrojnë mundësi të zgjerimit të kufijve të ndjenjave, mendimeve dhe veprimeve të individit në shoqëri, si edhe të njerëzve që përgatisin dhe realizojnë programe me rezultate të dukshme dhe të sinqerta.

Kështu që, edhe një herë dëshirojmë t'ju falënderojmë për vullnetin e mirë dhe kontributin Ju – znj. Erenestina dhe studentët e Klubit të Dramës, por gjithashtu edhe të kërkojmë nga ju për të zhvilluar më tej këto marrëdhënie, në një tryezë të rumbullakët me fokus dramaturgjinë shqiptare dhe studentët e rinj që duan ta provojnë dhe zhvillojnë veten në këtë lëmi. Detajet mbi këtë të fundit, do t'ua nisim së shpejti.

**Sinqerisht dhe me mirënjohje,**

**Drejtor**

**Jonida Beqo**

**Përgjegjëse e Sek. Edukimit**

**Sonila Kapidani**